REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2023
Nr. ref.:AGJ 2111/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI143/22

Parashtrues

Hidroenergji SH.P.K.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.UZVP.nr.51/2022 të 19 korrikut 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania Hidroenergji SH.P.K., me seli në Ferizaj e përfaqësuar me autorizim nga Fitim Shabani, avokat në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit ARJ. UZVP. nr. 51/2022 të 19 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin AA. nr. 386/2022 të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin A.nr. 3129/2021 të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon caktimin e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit ARJ. UZVP. nr. 51/2022 të 19 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme për shkak se: *"Zbatimi i [këtij Aktgjykimi] do të shkaktoj dëm të pariparueshëm material dhe jo -material për [parashtruesin e kërkesës, pasi që ai do të privohet nga e drejta në ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme bazuar në Lejen Ujore dhe Lejen Mjedisore të dhënë nga organet administrative [...]".*

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 56 (Kërkesë për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 26 shtator 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit Nr. GJR. KI143/22 caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 3 nëntor 2022, Gjykata njoftoi Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Organizatat Joqeveritare "Grupi për Studime Juridike dhe Politike" me seli në Prishtinë dhe "Gjethi" me seli Kaçanik për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 15 dhjetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të

njëjtën ditë, Gjykata vendosi: (i) të shpallë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) të shfuqizojë Aktgjykimin ARJ.UZVP.nr.51/2022 të 19 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme; Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit; dhe Aktvendimin [3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore; të kthejë për rishqyrtim Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës; dhe (iii) të refuzojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme.

11. Më 22 dhjetor 2022, pasi që Gjykata vendosi në lidhje me rastin, Organizata jo-qeveritare "Grupi për Studime Politike dhe Juridike" dhe Organizata jo-qeveritare "Gjethi" në Gjykatë dorëzuan komente lidhur me kërkesën.

Përmbledhje e fakteve

12. Si rezultat i nënshkrimit të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (në tekstin e mëtejmë: Traktati i Energjisë) në vitin 2005, Kosova mori obligimin që deri në vitin 2020 të prodhonte 25% të energjisë se saj të tërësishme nga burimet e ripërtërishme (neni 4 i Vendimit të Këshillit Ministror të Komuniteti të Energjisë Nr. D/2012/04/MC-EnC). Përmes nenit 15 (Caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme) të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë ishte përcaktuar që Qeveria të miratojë planin për arritjen e cakut prej 25% të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Përderisa me nenin 3 (Caku obligativ dhe indikativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme) të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për Caqet e Energjisë së Burimeve të Ripërtëritshme, të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë përveç cakut obligativ prej 25% të ishte përcaktuar edhe caku indikativ prej 29.89% të konsumit bruto të energjisë në Kosovë nga burimet e ripërtëritshme.

13. Më 25 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës u regjistrua pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë (në tekstin e mëtejmë: ARBK) si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për ushtrimin e aktivitetit nr. 3511 të prodhimit të energjisë.

14. Më 28 janar 2016, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Kaçanikut nxori Vendimin [V-755_2016] për lejimin e ndërtimit të Hidrocentralit në lumin Lepenc.

15. Parashtruesi i kërkesës, në Ministrinë e atëhershme të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor aplikoi për lejet ujore për shfrytëzimin e ujit nga lumi Lepenc për Hidrocentral me kapacitet 8.5 MW. Si rezultat i këtyre kërkesave, më 23 janar 2007, 17 janar 2013 dhe 6 qershor 2013, respektivisht, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Vendimeve të saja, parashtruesit të kërkesës i kishte lëshuar: (i) Leje Ujore për Hidrocentralin "HC Lepenci"; (ii) Leje Mjedisore; dhe (iii) aprovimin e pëlqimit ujor për vendosjen e tubacioneve përbri lumit Lepenc.

16. Më 13 dhjetor 2017, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) me parashtruesin e kërkesës nënshkroi marrëveshje "për blerje te energjisë për kapacitetet gjeneruese nga burime e ripërtëritshme të energjisë mbështetur nga rregulla për skemën mbështetëse [Hidrocentrali HC Lepenci 3]".

17. Më 15 maj 2019, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Kaçanikut, parashtruesit të kërkesës i lëshoi Certifikatën e përdorimit për Hidrocentralin Lepenci 3.

18. Më 5 qershor 2019, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejmë: ZREE) parashtruesit të kërkesës i lëshoi Licencën e Përkohshme [ZREE/Li_63/18] për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nga Hidrocentral "Lepenci 3" me kapacitet 9.98 MW për një periudhë një (1) vjeçare.

19. Më 5 qershor 2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit bazuar në rekomandimin e Drejtorit Rajonal të Pellgjeve Lumore dhe në nenin 71 (Procedurat për lëshimin e lejes ujore) të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës nxori Vendimin [6724-2/19-ZSP/20] për "lejen ujore në lumin Lepenc" për parashtruesin e kërkesës për një periudhë njëzet (20) vjeçare (në tekstin e mëtejmë: Vendimi për Lejen Ujore, të 5 qershorit 2020).

20. Më 26 qershor 2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit bazuar në paragrafin 2 të nenit 31 (Leja Mjedisore) të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit dhe Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 për Lejet Mjedisore nxori Vendimin [1948-4/19] për "pajisjen me leje mjedisore për Hidrocentralin Lepenci 3" për parashtruesin e kërkesës për një periudhë pesë (5) vjeçare (në tekstin e mëtejmë: Vendimi për Lejen Mjedisore).

21. Më 3 korrik 2021, Bordi i ZREE parashtruesit të kërkesës i lëshoi Licencën [ZREE/Li_63/20] për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nga Hidrocentral "Lepenci 3" me kapacitet 9.98 MË për periudhën katërdhjetë (40) vjeçare, gjegjësisht nga 3 korriku 2021 deri më 2 korrik 2059 (në tekstin e mëtejmë: Licenca e ZREE-së për prodhimin e energjisë).

22. Më 30 dhjetor 2021, Organizata Joqeveritare "Grupi për Studime Juridike dhe Politike", me seli në Prishtinë dhe Organizata Joqeveritare "Gjethi", me seli në Kaçanik (në tekstin e mëtejmë: paditësit/propozuesit) në Gjykatën Themelore kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit parashtruan:

(i) Padi administrative për anulimin apo shpalljen e pavlefshme të: (a) Vendimit [6724-19] për lëshimin e Lejes Ujore, të 5 qershorit 2020; dhe (b) Vendimit [1948-19] për lëshimin e Lejes Mjedisore, të 26 qershorit 2020 ; dhe
(ii) Propozim për shtyrjen e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve të lartcekura.

23. Në padinë e tyre administrative për anulimin e dy (2) Vendimeve për Lëshimin e Lejeve Ujore dhe asaj Mjedisore, të 5 qershorit 2020 dhe 26 qershorit 2020, respektivisht, të parashtruar në Gjykatën Themelore, paditësit/propozuesit, ndër të tjera, pretenduan:

(i) shkelje ligjore gjatë nxjerrjes së vendimeve të lartcekura, gjegjësisht, moszbatim të procedurës së koncesionit; mungesë të diskutimit publik; Leja Mjedisore e 26 qershorit 2020 është lëshuar në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit; Leja Ujore, e 5 qershorit 2020 është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Ujërat e Kosovës; dhe ndërtimi i hidrocentralit ka shkaktuar dëme në mjedis, i cili ka rezultuar në mohimin e ujit të pijes dhe ujitjes; si dhe
(ii) vërtetim të gabuar të gjendjes faktike gjatë nxjerrjes së dy vendimeve.

24. Përderisa në lidhje me propozimin e tyre për shtyrje të ekzekutimit të dy (2) Vendimeve për Lejen Ujore dhe Mjedisore, përkatësisht, paditësit/propozuesit bazuar në paragrafët 2 dhe 6 të nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejmë : LKA) pretenduan se: (i) ekzekutimi i dy vendimeve të kontestuara do t'i sillte dëm të pariparueshëm atyre dhe do të ishte në kundërshtim me interesin publik; dhe

(ii) shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të kontestuar nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare apo asaj të interesuar.

25. Më 6 janar 2022, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore parashtroi kërkesë për ndërhyrje në procedurë dhe kundërshtim të padisë së parashtruar nga ana e paditësve.

26. Më 12 janar 2022, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në cilësinë e palës së paditur në Gjykatën Themelore parashtroi përgjigje në padinë administrative dhe kërkoi që të refuzohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të dy Vendimeve të lartcekura.

27. Më 13 janar 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 3129/2021] aprovoi si të bazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës që të përfshihet në procedurë si palë me interes juridik.

28. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit (tjetër) [A. nr. 3129/2021], vendosi që të:

    (i) **APROVOHET** propozimi i paditësve-propozuesve, "Grupit për Studime Juridike dhe Politike" - Organizatë Joqeveritare me seli ne Prishtinë dhe Organizatës Joqeveritare "Gjethi" me seli në Kaçanik, si i bazuar.

    (ii) **SHTYHET** ekzekutimi i Vendimit për Leje Ujore (për aprovim dhe plotësimin e kushteve ujore të parapara me lejen paraprake ujore) për Hidrocentralin "HC Lepenci 3" me nr. Protokollit 6724-2/19 të 5 qershorit 2020 dhe i Vendimit për Lëshimin e Lejes Mjedisore për Hidrocentralin "Lepenci 3" për kompaninë "Hidroenergji" Sh.p.k. Ferizaj me Nr. Protokollit 1948-4/19 të 26 qershorit 2020, të padituës, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, deri sa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor, përkitazi me kërkesëpadinë e paditësve.

29. Gjykata Themelore në Prishtinë bazuar në paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së, duke shqyrtuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, konstatoi se: (i) *"paditësit-propozuesit ka[në] ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm vështirë do të riparohej dhe se shtyrja e tillë nuk është në kundërshtim me interesat e publikut. Këtë vlerësim gjykata e ka mbështetur në faktin se paditësit-propozuesit e kanë argumentuar mjaftueshëm se duke u bazuar në dispozitat e lartcekura janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi i paditësve-propozuesve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, deri sa gjykata të vendosë përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e paditësve konform dispozitave ligjore [paragrafët 5 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së]*"; dhe (ii) se ky vendim nuk e paragjykon epilogun përfundimtar të këtij konflikti administrativ.

30. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejmë: MMPHI) kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, të 13 janarit 2022 parashtruan ankesa në Gjykatën e Apelit.

31. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e palës së interesuar, në ankesën e tij pretendoi shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK); vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; zbatim të gabuar të LKA-së dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për Ujërat si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta prish Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 13 janarit 2022, të Gjykatës Themelore.

32. Në një datë të pasaktësuar, paditësit/propozuesit paraqitën përgjigje në ankesë me propozimin që ankesat të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore i 13 janarit 2022.

33. Më 21 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.120/2022]: (i) aprovoi ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe MMPHI si të bazuara; (ii) prishi Aktvendimin [A.nr. 3129/2021] të 13 janarit 2021 të Gjykatës Themelore; dhe (iii) lëndën e ktheu në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore.

34. Gjykata e Apelit konstatoi se: (i) aktvendimi i Gjykatës Themelore është nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga pika n), paragrafi 2 i nenit 182 dhe nenit 183 të LPK-së, në lidhje me nenin 63 të LKA-së për faktin se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyet e tij dhe se ekziston kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktvendimit thuhen dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës: (ii) paragrafi 2 i nenit 22 të LKA-së përcakton përmbushjen e kushteve në mënyrë kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, dhe në rastin konkret Gjykata Themelore nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me përmbushjen e këtyre kushteve; dhe (iii) nuk është vërtetuar nëse padia është paraqitur brenda aftit 30 ditor të përcaktuar me nenin 27 të LKA-së, për arsye se kërkesa e parashtruesve për shtyrje të ekzekutimit të dy vendimeve është pjesë përbërëse e padisë së tyre.

35. Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore në procedurë të rivendosjes: (i) "duhet të vërtetojë se paditësit/propozuesit a i'u kanë përmbajtur afatit ligjor për ushtrimin e padisë në gjykatë, i cili afat është prekluziv në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 27 të LKA-së"; dhe pas këtij konstatimi në lidhje me afatshmërinë (ii) të kufizohet në konstatimin e të provuarit të bazueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të dy Vendimeve ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së.

36. Më 12 prill 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 3129/21], vendosi që të:

I.APROVOHET propozimi i paditësve- propozuesve "Grupit për Studime Juridike dhe Politike" - Organizatë Joqeveritare me seli ne Prishtinë dhe Organizatës Joqeveritare "Gjethi" me seli në Kaçanik, si i bazuar.

II.SHTYHET ekzekutimi i Vendimit për Leje Ujore (për aprovimin dhe plotësimin të kushteve ujore te parapara me lejen paraprake ujore) për Hidrocentralin "He Lepenci 3" me nr. Protokollit 6724-2/19 i 5 qershorit 2020 dhe Vendimi për Lëshimin e Lejes Mjedisore për Hidrocentralin "Lepenci 3" për kompaninë "Hidroenergji" Sh.p.k. Ferizaj me Nr. Protokollit 1948-4/19 i 26 qershorit 2020, i të padituës, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, deri sa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor, përkitazi me kërkesëpadinë e paditësve.

37. Gjykata Themelore konstatoi se: (i) padia e paditësve ishte parashtruar brenda afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me ligj; (ii) *"paditësit-propozuesit ka[në] ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej dhe se shtyrja e tillë nuk është në kundërshtim me interesat e publikut. Këtë vlerësim gjykata e ka mbështetur në faktin se paditësit-propozuesit e kanë argumentuar mjaftueshëm se duke u bazuar në dispozitat e lartcekura janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi i paditësve-propozuesve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, deri sa gjykata të vendosë përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e paditësve konform dispozitave ligjore [paragrafët 5 dhe 6 të nenit 22 të*

LKA-së]" dhe (iii) se ky vendim nuk e paragjykon epilogun përfundimtar të këtij konflikti administrativ.

38. Më 27 prill 2022 kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, të 12 prillit 2022, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK); vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe zbatim të gabuar të LKA-së dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare., me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta prish Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 13 prillit 2022, të Gjykatës Themelore. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, të 12 prillit 2022, ankesë në Gjykatën e Apelit parashtroi edhe MMPHI.

39. Më 26 maj 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 386/2022] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe MMPHI dhe vërtetoi Aktvendimin [A.nr. 3129/2021] e Gjykatës Themelore, të 12 prillit 2022.

40. Gjykata e Apelit vlerësoi dhe gjeti se:

(i) *"[...] pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tille te gjykatës se shkalles së parë, ngase edhe sipas vlerësimit te kolegjit te kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar ne mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit te aktit administrativ te parapara ne nenin 22 par.2 te Ligjit për Konfliktet Administrative." ;*

(ii) vlerëson ankesat e MPPHI dhe parashtruesit të kërkesës, respektivisht janë të *"pa bazuara dhe te paargumentuara me prova konkrete, te pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.";*

(iii) nga Gjykata Themelore është provuar afatshmëria e padisë së paditësve/propozuesve ;

(iv) Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë i është referuar nenit 12 te Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 52 te Kushtetutës dhe nenit 5 paragrafit 1, pikës 1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;

(v) Gjykata Themelore *"drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar si të bazuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara, ngase kjo shmang pasojat e mundshme që do të shkaktoheshin në të ardhmen nëse vendimet e kontestuara të padituës në fund të procesit gjyqësor rezultojnë se janë marre në kundërshtim me ligjin";*

(vi) ky vendim është nxjerrë pa paragjykim ndaj epilogut të shqyrtimit të meritave të padisë;

(vii) Gjykata Themelore në mënyre të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në po ashtu në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin material ; dhe

(viii) Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Themelore është *"i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë [...] ".*

41. Më 10 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjegjësisht kontestoi Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të Gjykatës Themelore, të 12 prillit 2022 dhe Aktvendimit [AA. nr. 386/2022] të Gjykatës së Apelit, të 26 majit 2022 për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kërkesa e tij të aprovohet, dhe të prishen dy aktvendimet e kontestuara të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, respektivisht.

42. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, në lidhje me pretendimin për zbatim të gabuar të drejtës materiale theksoi se gjykatat e shkallës më të ultë në mënyrë të gabuar kanë zbatuar nenin 22 të LKA-së. Në lidhje me këtë,

parashtruesi i kërkesës specifikoi se: *"Gjykata e shkalles së parë nuk ka vepruar drejt kur e ka bërë të besueshëm kërkesën e paditësit, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t'i sjelle dëm paditësve i cili dëm vështire do të riparohej, dhe se shtyrja e tille nuk është në kundërshtim me interesat e publikut. Pastaj, se paditësit kanë argumentuar mjaftueshëm faktin se janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve, derisa gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e tyre. Kjo për faktin e pamohueshëm se nuk janë vërtetuar fare faktet vendimtare, dhe nuk janë marra për baze asnjë prove materiale e palës së dëmtuar, ku nga shkresat e lëndës kemi arritur të dëshmojmë se jemi pajisur me vendimet për leje Ujore dhe Lejen Mjedisore sipas kushteve ligjore dhe duke i përmbushur të gjitha kushtet sipas pëlqimit mjedisor dhe kushteve ujore, të cilat kanë qenë dokumente bazë mbi bazën e sa cilës kemi ushtruar aktivitetin e ndërtimit dhe pas finalizimit edhe të operimit për më shume se 4 vite. [...] Përkundër se në mënyre kumulative nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, gjykata ka refuzuar ankesën e palës paditëse dhe të palës së interesit juridik [parashtruesit të kërkesës], edhe pse me ankesë kemi arritur ti dëshmojmë se shtyrja e tille do të ketë pasoja për interesin publik dhe të sektorit të energjisë elektrike si dhe mungesë të prodhimit të energjisë së pastër dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe materiale, pasi që shtyrja e ekzekutimit të vendimeve per Leje Ujore dhe Leje Mjedisore, do të ketë pasoja të pariparueshme dhe dëmi do të ishte me pasoja të mëdha financiare dhe energjetike, rrjedhimisht do të kemi mungesë të sigurisë juridike dhe dëmtim të qëllimshëm material, pasi qa me aktvendimin për shtyrje pasojat do të jenë katastrofale për zingjirin e furnizimit me energji elektrike dhe dëme të mëdha publike, as ligji për konfliktet administrative nuk ka ofruar siguri juridike, përveç për çështjet meritore, dhe mbi këto baza, gjykata gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale".*

43. Në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës, parashtruesi i kërkesës specifikoi se: *"Pala e interesit juridik me te drejt vë në pah faktin e pamohueshme se gjykatat e rregullta janë të obliguara t'i trajtojnë të gjitha provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësve me kujdes dhe ndërgjegje. Kjo si parim bazë i procedurave gjyqësore i shprehur specifikisht në par. 2 të nenit 8 te LPK-së. [...]do të duhej përshtshmërisht dhe në pajtim të plotë me nenin 175 te LPK-së, që dispozitat të zbatohen edhe për aktvendime, përfshirë rastet për vendosjen lidhur me kërkesën për shtyrje te ekzekutimit te vendimit ne procedure sipas konfliktit administrativ. Mostrajtimi adekuat i fakteve dhe provave nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të shkalles së parë duke përdorur standarde te dyfishta edhe në riprocedurë ka cenuar rëndë barazinë e palëve në procedurë dhe objektivitetin e gjykatës, duke krijuar një standard të padrejt dhe në dëm të palës sa interesit juridik dhe praktik që vë në pah njëanshmërinë e gjykatës, pasi që gjykatat janë duke u mbështetur vetëm në baza të perceptimit të opinionit publik kundërshtues për gjithqka me theks të veqant nga ana e paditëses duke u thirrur në atë sa janë duke i mbrojtur të drejtat e qytetarëve, pa i parashikuar edhe pasojat juridike dhe të dëmshme dhe në favor të tregtareve të energjisë qe kryesisht janë duke përfituar në dëm të qytetarëve të vendit, duke blerë energji në shuma prej me shumë se 250 euro për MË/h, e duke e dëmtuar interesin publik me qmime më të ulta dhe mirëqenën e qytetarëve të vendit. [...] Aktvendimet e tilla të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, bien ndesh me praktikën e krijuar nga ana e Gjykatës Supreme, sipas të cilës vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara lidhur me të gjitha pretendimet dhe kërkesat e palëve ndërgjygjëse".*

44. Në fund, parashtruesi i kërkesës arsyetoi se: *"Nga ajo qe u dëshmua me lart përveq përshkrimit të dispozitave relevante ligjore të përcaktuara ne nenin 22 te LKA-se, asnjëra prej gjykatave nuk kanë dëshmuar me asnjë prove apo argument në mbështetje të plotësimi te kritereve ligjore për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit. Për faktin sa edhe Gjykata Kushtetuese ka theksuar në disa raste "drejtësia procedurale e*

kërkon qe pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur posaqërisht nëse atë kane te bëjnë me pretendimet vendimtare, që ne rastin konkret i referohet vetëm pretendimeve të paditësit/propozuesit, duke injoruar faktet vendimtare të të padituës dhe palës se interesit juridik si palë e dëmtuar në këtë proces, e cila i ka të mbështetura në parimet ligjore, të definuara me ligj, dhe ku është ndjekur qëllimi legjitim i përcaktuar me dispozita ligjore të mbështetua ne legjislacionin primar dhe në Kushtetutë".

45. Më 19 korrik 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër Aktvendimit [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022.

46. Gjykata Supreme konstatoi si në vijim:

"Duke pasur parasysh dispozitat e paraqitura sipër të Ligjit për konfliktet administrative, kjo gjykate ka gjetur se gjykata e shkalles se dyte ka vepruar drejt kur ka refuzuar si te pabazuara ankesat e te padituës - Ministrisë se ambientit, planifikimit hapësinore, infrastrukturës dhe palës se interesuar "Hidroenergji" sh.p.k Lepenci 3, te parashtruara kundër aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine - Departamenti për Çështje Administrative A. U .nr. 3129/2021 dt. 12.04.2022, me te cilin është aprovuar si i bazuar propozimi i propozuesve - paditësve organizatës joqeveritare "Grupi për studime juridike dhe politike" dhe organizatës joqeveritare "Gjeti" për shtyrje te ekzekutimit te vendimit te padituës nr. 6724-2/199 dt. 05.06.2020 dhe vendimit nr. 1948-4/19 dt 26.06.2022 deri ne nxjerrjen e aktgjykimit te shkalles se pare sipas padisë se paditësve.

Vendimet e tilla të gjykatave të instancës më të ulët kanë rezultuar nga provat në shkresa të lëndës, ngase sipas mendimit të kësaj gjykate zbatimi i vendimeve të padituës të kontestuara me padi, paraqet rrezik te shkaktimit te dëmit paditësve i cili vështirë do të riparohej nëse merret parasysh shkaktimi i dëmit mjedisit jetësor që do të mund t'i shkaktohej të njëjtit, degradimit potencial të natyrës dhe të veçorive të saja si dhe të ekuilibrit të përgjithshëm te natyrës.
[...]
Sipas mendimit të kësaj gjykate, paditësit – propozuesit përmes padisë dhe provave të bashkëngjitura me padi, kanë ofruar prova bindëse me të cilat vërtetohen faktet se ekzekutimi i vendimeve do të sillte dëm qytetareve të cilët jetojnë në pronat tyre dhe jetojnë në atë mjedis ku është parapare puna e këtyre hidrocentraleve, me çfarë do të shkaktohej dëm i pa kompensueshëm atyre.

Poashtu, kjo gjykatë ka gjetur se ekzekutimi i vendimeve deri në nxjerrjen e vendimit meritor nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe as shtyrja nuk do të sillte ndonjë humbje më të madhe palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Ne këtë mënyrë do të shmangeshin pasojat e mundshme në të ardhmen në rast se do të vërtetohej se vendimet e kontestuara të padituës, në fund te procesit gjyqësor do të rezultonin në kundërshtim me ligjin. Duhet po ashtu të theksohet që sipas mendimit të kësaj gjykate, shtyrja e ekzekutimit të vendimit të padituës me asgjë nuk mund të prejudikohet, ngase bëhet fjalë për një vendim të përkohshëm, gjegjësisht i njëjti vlen deri në nxjerrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkalles së parë sipas padisë së paditësit.

Nisur nga kjo që u parashtrua, Gjykata Supreme ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje juridike -- administrative ka aplikuar drejtë dispozitat e procedurës administrative dhe të kontestit administrativ, dhe se pretendimet në kërkesën e palës së interesuar "Hidroenergji" sh.p.k Lepenci për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësore janë të pabazuara, ngase nuk janë me ndikim

për vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkalles së dytë. Sipas vlerësimit të gjykatës, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkalles së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetim të aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të palës së interesuar "Hidroenergji" sh.p.k Lepenci 3 apo të paditurës."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

48. Parashtruesi i kërkesës ka ngritur pretendime të detajuara në lidhje me:

(i) aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret;
(ii) pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i: (a) mungesës së arsyetimit të Aktgjykimit të kontestuar; dhe (b) aplikimit të gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme;
(iii) pretendimin për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; si dhe
(iv) kërkesën për caktim të masës së përkohshme.

(i) Arsyetim lidhur me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin të KEDNJ-së

49. Parashtruesi i kërkesës konsideron se kërkesa e tij përmbushë të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe se Gjykata duhet ta pranojë ketë rast për shqyrtim të meritave në bazë të kritereve të përcaktuara në Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Micallef kundër Maltës* (kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, 15 tetorit 2009) por edhe rastet e Gjykatës KI122/17 me parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim, i 30 prillit 2018) dhe KI195/20 me parashtrues *Aigars Kesengfelds,* Aktgjykim i 19 prillit 2021).

50. Parashtruesi i kërkesës pohon se është i vetëdijshëm se neni 6 i KEDNJ-së, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe po ashtu, kupton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme për të cilin pretendon se është i përfshirë në shkelje të të drejtave të njeriut nuk iu përkon meritave të rastit, por ka të bëjë me një procedurë paraprake, respektivisht me caktimin e masës se përkohshme. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton se edhe Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI122/17 ka konstatuar se mund të ketë raste ku procedurat paraprake mund të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile të parashtruesit të kërkesës.

51. Duke iu referuar rastit *Micallef kundër Maltës, ([DHM]* kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, i 15 tetorit 2009), parashtruesi i kërkesës thekson: *"Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i Nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shumë Shteteve Kontraktuese u duhet të përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tej zgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër*

ndalues shpesh ndodh që është i barasvlershëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë dhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodh që procedurat për masa provizore dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme".

52. Duke iu referuar rastit të Gjykatës KI122/17, parashtruesi i kërkesës shton: "*Gjykata në këtë Aktgjykim i përcakton dy (2) kritere të cilat duhet të vlerësohen lidhur me atë se "a mund të mbulohen masat e përkohshme me nenin 6 të KEDNJ-së". Gjithnjë sipas këtij gjykimi, kushti i parë është (i) kualifikimi i të drejtës ne fjale si "civile", dhe kushti i dytë (ii) duhet të vlerësohet natyra e masës së përkohshme, se a konsiderohet një masë e tille e asaj rëndësie që përcakton në mënyrë efektive të drejtën civile ose detyrimin në fjalë*".

53. Parashtruesi i kërkesës pohon se në rrethanat e rastit të tij: "*Të dy kushtet plotësohen ne mënyrë kumulative [...]. Sa i përket kushtit të parë (i) parashtrojmë se Licenca ZRRE_63/20, për periudhën katër dhjetë (40) vjeçare për prodhimin e energjisë elektrike, te dhëna nga Zyra e Rregullatorit për Energji me vendimin [V -1267 -2020 3 korrikut 2020] bazuar ne Lejen Mjedisore Ekologjike [nr. 19/19841, të 26 qershorit 2020] dhe Lejen Ujore [nr. 6724-2/19 të 5 qershorit 2020] te lëshuar nga MMPHI (autoritet publik), me të cilën parashtruesi i kërkesës ka disponuar që nga 3 korriku i vitit 2020, përbejnë të " drejta civile" në formën e autorizimit për të prodhuar energji elektrike në kuadër te Hidrocentralit ekzistues He Lepenci 3 në komunën e Kaçanikut dhe për të shitur me Kontrate përmes Marrëveshjes për Blerje të Energjisë tek ndërmarrja shtetërore KOSTT, nën garancionin e ZRRE-se, sipas detyrimeve ndërkombëtare për të prodhuar energji të pastër nga Burimet e Renovueshme*".

54. Parashtruesi i kërkesës shton se aprovimi apo mos aprovimi i shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, ka ndikim thelbësor në të drejtën civile të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe sikur në fund ta fitojë rastin në merita, ai prapëseprapë do të pësojë dëm të pariparueshëm sepse vendimmarrja meritore në departamentin administrativ të Gjykatës Themelore së paku zgjat tre (3) vjet. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës specifikon se: "*një pezullim kaq i gjatë i veprimtarisë se kësaj ndërmarrje, do të rrezikonte seriozisht vet ekzistencës e kësaj kompanie, largimin e punëtoreve nga puna, dhe dëme tjera zingjirore të furnizimit*".

(ii) Pretendimi lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

55. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës se tij ne gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 te Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ - së: (a) për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, respektivisht Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore; dhe (b) mungesës se arsyetimit te vendimit të kontestuar gjyqësor.

56. Parashtruesi i kërkesës pohon se është i vetëdijshëm se këto pretendimet e mëposhtme kanë të bëjnë me çështje të ligjit dhe të faktit mirëpo që në rastin e tij po ashtu bëhet fjalë për vlerësim arbitrar të fakteve dhe zbatim arbitrar e të paarsyeshëm të ligjit. Për ta përforcuar këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI195/20 [të cituar më lart] duke theksuar se: "*Gjykata Kushtetuese duhet te sigurohet dhe te ndërmarr masa kur vëren se një gjykate ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi te gabuar ne një rast specifik e qe mund te ketë rezultuar ne "konkluzione arbitrare" apo "qartazi te paarsyeshme".*

(a) Në lidhje me pretendimin për zbatim të gabuar të "drejtës procedurale"

57. Sipas parashtruesit të kërkesës: *"Zbatimi i gabuar i dispozitave ligjore procedurale, ka të bëjë me mos-plotësimin e kushteve nga Neni 22 par. 1 i LKA-se, për caktimin e masës se përkohshme, shtyrja e ekzekutimit te vendimeve te MMPHI(ish MEA). Këto shkelje kanë ndikuar në shkelje të të drejtave te parashtruesit te Kërkesës - ashtu siç do te elaborohet në vazhdim të kësaj kërkese".*

58. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se : *"[...] gjykatat në fjalë përkundër asaj se janë të obliguara që të ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm përmes provave të dëshmuara nga shkresat e lëndës, dhe të njëjtat ti përfshijnë në arsyetimin e Aktvendimit, pra standardi ligjor është detyrim i përcaktuar shprehimisht me par. 4 të nenit 160 LPK-se, ku decidivisht përcaktohet se: "arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kane parashtruar dhe provat qe i kane propozuar, cilat nga faktet i ka vërtetuar, pse i ka vërtetuar ato fakte, , e po qe se i ka vërtetuar me ane te provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato".* Sipas tij: *"Mostrajtimi adekuat i fakteve dhe provave nga ana e Gjykatës Supreme ka cenuar rëndë barazinë e palëve në procedure dhe objektivitetin e gjykatës, duke krijuar një standard të pa drejt dhe ne dëm të parashtruesit të kërkesës, dhe një praktik që vë në pah njëanshmërinë e gjykatës, pasi që gjykatat janë duke u mbështetur vetëm në bazë të përcaktimit të opinionit publik kundërshtues për gjithçka me theks të veçantë nga ana e paditëseve të cilët janë duke i kundërshtuar të gjitha Hidrocentralet ekzistuese të ndërtuara sipas standarteve dhe të pajisura me leje finale, dhe duke u thirur në atë se janë duke i mbrojtur të drejtat e qytetarëve pa dëshmuar me asnjë fakt se janë të autorizuar ti përfaqësojnë, pa i parashikuar edhe pasojat juridike dhe të dëmshme dhe në favor të tregtarëve të energjisë që kryesisht janë duke përfituar në dëm të qytetareve të vendit, duke blerë energji me shuma prej mbi 400 Euro MWh, e duke gjenerator me qmim prej 67.47 Euro MWh të përcaktuar nga ZRRE-ja për periudhën 10 vjeçare të pa ndryshuar".*

59. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Është tejet shqetësues interpretimi qe Aktgjykimi i ankimuar iu bën kushteve që parashihen në Ligjin për Konfliktet Administrative. Një keq-interpretim i tillë substancial dhe zbatim i gabuar i këtyre kushteve përbën një lëshim serioz profesional me pasoja të mëdha për rendin dhe sigurinë juridike në vend [...] në rast se vendimi i Gjykatës Supreme mbetet në fuqi deri në vendosjen meritore të kërkesës kryesore, parashtruesit të kërkesës do t'i shkaktohet dëm i madh dhe i pariparueshëm material nga humbjet në prodhimin e energjisë, si dhe dëm jo-material ndaj reputacionit të tij. Humbjet në prodhim të energjisë kalkulohen bazuar në shifrat e përgjithshme të prodhimit, ndërsa dëmi jo-material ndaj reputacionit si një investitor i njohur i kalon shifrat e dëmit material".*

60. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata gabimisht ka vendosur edhe kur ka cituar Ligjin për Mbrojtje te Mjedisit, pasi që e njëjta vetëm ka bere përshkrimin e nenit 12 të këtij të fundit.

61. Rrjedhimisht sipas parashtruesit të kërkesës: *"Gjykata Supreme nuk ka vlerësuar drejt as dispozitat e Ligjin për Mbrojte te Natyrës duke u thirrur vetëm ne nenin 5 par. 1.5 ne parimin e pjesëmarrjes se publikut, e ku konsiderojmë se kjo e drejt është konsumuar me te gjitha palët e interesit qe nga fillimi e deri ne përfundim te realizimit te Hidorcentralit Lepenci 3, pasi që pa u plotësuar kushti i dëgjimeve Publike ne nuk kishim mundur të pajisemi me Pëlqim Mjedisor sepse kusht ka qenë zhvillimi i debateve publike para marrjes se Pëlqimit Mjedisor".*

62. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës pretendon se padia administrative e paditësve/propozuesve është parashtruar jashtë afatit të paraparë me nenin 27 të LKA-së.

63. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit në kuptimin e nenit 22 të LKA-së, duhet të plotësohen tri (3) kushte: (a) me ekzekutimin e vendimit paditësit do t'i shkaktohej dëm që vështire do të riparohej; (b) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe (c) shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare apo personit të interesuar.

64. Sipas parashtruesit të kërkesës, asnjeri nga këto tre (3) kushte nuk janë përmbushur.

65. Në lidhje me kushtin e pare ai specifikon se: *" [...] nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit dhe te Gjykatës Themelore ne Prishtine, nuk është e qarte se cili është dëmi i drejtpërdrejt apo i tërthortë i pariparueshëm qe do t'i sillte paditësve dhe do te ishte ne kundërshtim me interesin publik ku është duke u fornizuar hidorcentrali Lepenci 3, ne rast te ekzekutimit te vendimit për Leje Ujore dhe Leje Mjedisore te MMPHI(ish MEA). Asnjëra nga këto tri (3) gjykata, nuk iu është referuar ndonjë prove materiale me të cilën do të dëshmohej pretendimi i paditësve për dëmin e pariparueshëm që do t'u shkaktohej atyre dhe që është në kundërshtim me interesin publik, duke saktësuar se në çfarë mase po i shkaktohen dëm i pariparueshëm florës dhe faunës, qasjes në ujë të pishem për qytetarët, pejsazhin natyrore, turizimin, malor dhe të varfnohen bujqit që jetojnë nga toka e tyre dhe varen nga rrjedha e natyrshme e ujit për ujitje të tokës. Gjykata shkallës së parë duke mos vepruar në pajtim me nenin 306 par. 2 të LPK-se, i aplikueshëm sipas nenit 36 dhe nenit 38 par. 1 dhe 2 të LKA-se, për vërtetimin e drejt të të trijave kushteve të parapara me nenin 22 të LKA-se, do të duhej që të caktonte seancë dëgjimore në të cilën do të vërtetonte drejtë se pa sjelljen e vendimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar dotë shkaktoheshin për paditësin dëm i pariparueshëm dhe do të ishte në kundërshtim me interesin publik. Këtë gjë gjykata e shkalles së parë por edhe ajo e shkalles se dytë, perveq përshkrimit të dispozitave të nenit 22 te LKA-se, do të duhej ta kishin parasysh edhe nga fakti se lejet dhe Licenca përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike i lëshojnë institucionet dhe organet kompetente të detyruara dhe autorizuar me ligj që me rastin e lëshimit te këtyre lejeve dhe Licencës, të kujdesen për mbrojtjen e natyrës dhe interesin publik".*

66. Ndërsa në lidhje me kushtin e dytë, parashtruesi i kërkesës vazhdon se: *"[...] se shtyrja e ekzekutimit te vendimeve te kontestuara të MMPHI-se, është ne kundërshtim me interesin e përgjithshëm ngase parashtruesi i kërkesës i posedon i ka ne pronësi vendimet për Leje ujore dhe Leje Mjedisore(Ekologjike) dhe Licencën nga ZRRE-ja për prodhimin e energjisë se ripertritshme me te cilat ka marr obligim qe me rastin e prodhimit te energjisë elektrike t'iu përmbahet kushteve për mbrojtjen e ambientit, respektimin e minimumit biologjik sipas Lejes Ujore dhe kushtet tjera te përcaktuara sipas kornizës ligjore dhe rregullative në Kosovë. [...] Përveç; kësaj, shtyrja e ekzekutimit te Lejes Ujore dhe Lejes Mjedisore për prodhimin e energjisë elektrike te gjelbërt prej hidorcentralit Lepenci 3 e afekton negativisht zhvillimin e sektorit te energjisë ne Kosove dhe e afekton negativisht klimën e investimeve për zhvillimin e gjeneratës se re te kapaciteteve te gjenerimit nga burimet e ripertritshme te energjisë ne Kosove." Më tej, parashtruesi i kërkesës specifikon se: " Duke pasur parasysh se procesi i lejeve dhe Licencës se prodhimit për hidrocentralin e kontestuar të kompanisë "Hidroenergji" Sh.p.k., Është ekzekutuar nga institucionet përgjegjëse brenda kornizës ligjore-investitori është i lire nga çfarëdo përgjegjësie si pasoj e intervenimit të tillë të palëve të treta. Rrjedhimisht nje veprim i tille është me rrezik te madh për interesin publik te Kosovës, meqë parashtruesi i kërkesës pa vonese do të detyrohet të përdorë instrumentet ligjore kundër Republikës se Kosovës për kompensimin e dëmit material dhe fitimit te humbur për dyzet (40) vite. Kjo kërkese për kompenzim kundër Republikës së Kosovës mund të jetë e lart sa vlera e përgjithshme e investimit të dështuar".*

67. Në lidhje me kushtin e tretë, parashtruesi i kërkesës parashtron: *"[...] se as kushti i tretë për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit për leje ujore dhe Leje Mjedisore të kontestuara te MMPHI-se, nuk është i përmbushur. Kompania "Hidroenergji" Sh.p.k., është një kompani serioze ne ndërtimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e renovueshme (pastra) te energjisë ne Kosove, dhe aktivitetin e saj e ka prodhimin e energjisë elektrike. Kompania në realizimin dhe ndërtimin e kapaciteteve te reja gjeneruese nga Hidrocentrali Lepenci 3 ka investuar mes shumë se 16 milion euro, duke i përmbushur te gjitha kushtet teknike, mjedisore dhe ato komerciale. Ka kryer çdo studim te mundshëm dhe ka realizuar edhe Vlerësimin e ndikimit ne Mjedis, ku pas zhvillimit te Debateve Publike me qytetar nga Ministria e mjedisit është pajisur me Vendimin për Pëlqimin Mjedisor d.m.th. para të pajiset me Leje ndërtimore dhe te ndërton projektin, i cili pasi është komisionuar është pajisur me certifikata te përdorimit Leje Ujore, Leje Mjedisore (sipas Kushteve te Pëlqimit Mjedisor) dhe Licenc për prodhimin e energjisë elektrike, te gjitha këto kushte janë përmbushur sipas legjislacionit ne fuqi dhe janë lëshuar nga institucionet relevante të autorizuar me ligj për lëshimin e tyre." Në vijim të kësaj, ai pohon se: "[...] deri në vendosjen e çështjes meritore të kërkesës kryesore, parashtruesit të kërkesës do t'i shkaktohet dëm i madh dhe i pariparueshëm material nga humbjet ne prodhimin e energjisë, si dhe dëm jo-material ndaj reputacionit te tij. Pasi investitori është ftuar nga Shteti i Kosovës për të investuar ne burimet e renovueshme, dhe shteti do të duhej ti ofronte edhe siguri juridike në investim dhe ne operim, sepse te gjitha lejet janë lëshuar dhe shtetit i mbetet ti monitoroj lejet dhe te ndërmarr masa ligjore për mos përmbushje të kushteve, e jo me masa të tillë gjyqësore të pezullohet pafundësisht operimi. Poashtu humbjet në prodhim të energjisë kalkulohen bazuar në shifrat e përgjithshme të prodhimit, ndërsa dëmi jo-material ndaj reputacionit si je investitor kredibil i kalon shifrat e dëmit material".*

68. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konkludon se Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore, duke zbatuar gabimisht dispozitat ligjore dhe duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, kanë arritur te vendimi i padrejtë dhe i paligjshëm, që ka rezultuar ne shkelje të së drejtës ne gjykim te drejtë dhe te paanshëm të parashtruesit te kërkesës.

(b) Pretendimi për mungesë të vendimit të arsyetuar

69. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thekson se meqenëse Gjykata Supreme ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe ka lënë ne fuqi Aktvendimin e Apelit me te cilin është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine, e njëjta ka qenë e detyruar që ta arsyetojë në detaje vendimin e saj për caktimin e masës së përkohshme, duke i saktësuar qartë arsyet për faktet vendimtare dhe provat materiale në të cilat ka mbështetur konstatimin e saj. Parashtruesi i kërkesës thekson se arsyetimi i Aktgjykimit te Gjykatës Supreme në asnjë moment nuk ka arsyetuar thëniet dhe argumentet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura në kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit gjyqësor pranë Gjykatës Supreme.

70. Në lidhje me atë si më lart, parashtruesi i kërkesës vë në dukje se: *"Në frymën e këtyre dispozitave, është obligim i Gjykatave qe te vlerësojnë ne mënyrë te paanshme pretendimet e te gjitha palëve-gjë e cila ne rastin konkret nuk ka ndodhur. Gjykata Supreme ne rastin konkret nuk ka ekzaminuar fare çështjet e ngritura nga ana e Parashtruesit te Kërkesës. Parashtruesi i Kërkesës ne te gjitha parashtrimet e tij me shkrim, para te gjitha instancave gjyqësore kishte argumentuar ne detaje me fakte dhe prova materiale për gjendjen ne terren(te shkëlqyeshme), lidhur me secilin pretendim te palës paditëse. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës kishte shkuar edhe*

përtej kësaj duke argumentuar dhe provuar se ne fakte se aprovimi i kërkesës për shtyrje te vendimeve do te ishte ne kundërshtim me interesin publik. Për me tepër, do te duhet te analizohet edhe kërkesa për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor e paraqitur ne provën 18 e kësaj kërkese. Ne këtë kërkesë janë adresuar të gjitha pretendimet se aktvendimet e gjykatave me te ulta janë të pa drejta dhe te pa arsyetuara drejt. Për me tepër Gjykata Supreme fare nuk i adreson çështjet ne ngritura nga parashtruesi i kërkesës. 64. Ne lidhje me shkeljet e mësipërme te Nenit 6 të KEDNJ-se, dhe Nenit 31 të Kushtetutës, Parashtruesi i Kërkesës konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i përmban kriteret minimale të arsyetimit të një vendimi- meqë e njëjta nuk ka respektuar standartin e arsyetimit te vendimeve gjyqësore, dhe si e tillë bie në kundërshtim me garancitë e mveshura ne Nenin 6 te KEDNj-së, dhe Nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis, rastin KI138/15, parashtruesi i kërkesës Sharr Beteiligungs GmbH sh.p.k., Aktgjykimi i datës 20 dhjetor 2017.)".

71. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pohon se Gjykata Supreme duke mos ofruar arsyetim të mjaftueshëm të vendimit të saj gjyqësor vepron me një mospërfillje shqetësuese ndaj argumenteve të tij. Sipas parashtruesit të kërkesës mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm të vendimit të Gjykatës Supreme ka rezultuar në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

72. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme nuk ka argumentuar mbi faktet vendimtare të kërkesës dhe nuk ka adresuar argumentet dhe provat e paraqitura nga ai, dhe si rrjedhojë Aktgjykimi i kësaj gjykate sipas tij ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

(iii) Pretendimet në lidhje me të drejtën në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

68. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmes të cilit është shtyrë ekzekutimi i vendimeve për dhënien e lejeve ujore dhe mjedisore që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së tij për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ka cenuar të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të drejtës së tij në pronë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), përkatësisht rasteve: *Tre Traktorer AB kundër Suedisë; Pressos Compania Naviera SA et al kundër Belgjikës; Capital Bank AD kundër Bullgarisë, Lönnroth kundër Suedisë dhe Saliba kundër Maltës.*

73. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh të gjitha aktet juridike dhe normat imperative, fundamentale që ato përmbajnë në lidhje me të drejtën në pronë e sidomos "përcaktimin e Kushtetutës në lidhje me këtë të drejtë-shihet qartë se-e drejta në pronë është e drejtë fundamentale dhe e pacenueshme e njeriut", marrë për bazë faktin që kjo e drejtë hyn në kapitullin II të Kushtetutës për të Drejtat dhe Liritë Themelore.

74. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Duke pasur për bazë jurisprudencën e GJEDNJ-së-nëpërmjet Nenit 53 të Kushtetutës-duhet pasur parasysh se koncepti i pronësisë është shume gjerë i interpretuar. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së ky koncept nuk përfshin vetëm pronën dhe të drejtën mbi të-në kuptim material dhe klasik të fjalës, por përfshinë një gamë të gjerë të të drejtave monetare-të drejta që rrjedhin nga, ndër të tjera, licencat e po ashtu edhe të drejtat që rrjedhin nga drejtimi i një biznesi [...] Madje, duke shkuar edhe më larg, në Pressos Compania Naviera SA et al [kundër Belgjikës], GJEDNJ përfundoi se edhe një kërkesë për kompensim mund te*

konsiderohet si aset - ne kuptim të pasurisë dhe gëzon mbrojtje sipas Nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së kur provohet mjaftueshëm nga pala se ekziston pritja legjitime që një kërkese e tillë mund të realizohet".

75. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së pajisja me licencë përbën pritje legjitime që ai ta kryen veprimtarinë e tij në mënyrë të papenguar për shkak se ai i ka plotësuar kushtet ligjore në çastin kur është pajisur me licencë, prandaj, pritja legjitime e parashtruesit të kërkesës gëzon mbrojtje nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

76. Sipas parashtruesit të kërkesës: "*Leja Ujore dhe Leja Mjedisore qe janë dhënë parashtruesit te kërkesës nga ana e MMPHI, dhe pajisja me Licence te prodhimit nga ZRRE, janë esenciale për aktivitetin e kësaj kompanie, ngase ne momentin e zbatimit te një vendimi gjyqësor siq është vendimi për shtyrje te ekzekutimit te vendimeve te kontestuara si mase e përkohshme, me te cilën ndalohen plotësisht operimi mbi bazën e atyre lejeve, kompania është e detyruar te ndaloje ne tërësi veprimtarinë e saj deri ne vendosjen meritore te çështjes nga gjykata. Në lidhje me këtë ai pretendon se: "Marr parasysh mbingarkesën e gjykatave ne fjale, dhe praktikave ne rastet tjera, një vendim meritor për çështjen ne fjale mund te merret pas me shume se (3-4) vite, edhe përkundër se besojmë se e drejta do te mbizotërojnë ne rastin e parashtruesit, pasi qe nga fillimi i ndërtimit, finalizimit, pranimit teknik, komisionimit ambiental, dhe fillimit te operimit janë respektuar te gjitha kushtet dhe obligimet e dhëna me ligj dhe nga institucionet përgjegjëse jemi pajisur me lejet dhe Licencën për prodhim te energjisë elektrike nga burimet e renovueshme, dhe çdo kohe e pezullim do te do te jete ne shkelje të të drejtave te parashtruesit te kërkesës".*

77. Në mbështetjen e pretendimit si më lart, parashtruesi i kërkesës specifikon se: "*Për te vërtetuar edhe dëmin qe i shkaktohet padrejtësisht [atij] mjafton vetëm te shikohet prodhimi i energjisë elektrike, nga burimet e ripërtëritshme për vitin 2019-2021 nga ana e këtij te fundit. Sipas Raporteve te KOSTT, energjia elektrike e prodhuar dhe lëshuar ne rrjet për konsum nga konsumatorët e Kosovës (energji e pastër), nga ana e Parashtruesit te kërkesës për vitin 2019 nga muaji qershor është 5,134, 000 kWh energji elektrike nga 191,700,000 kWh te prodhuar nga burimet e renovueshme ne Kosovë. Poashu në vitin 2020 parashtruesi i kërkesës ka prodhuar 28,159,000 kWH energji të pastër elektrike, ndërsa ne vitin 2021 ka prodhuar 25,124,000 kWH energji te pastër elektrike. Këto te dhëna dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës me pamundësinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i respektuar edhe prurjet biologjike sipas Lejes Ujore, do t'i shkaktohet dëm jashtëzakonisht i madh, dhe për pasoj dëmtim edhe jo -material".*

78. Në vijim, ai thekson se: "*Përveç se dëmi është i madh ne kuptim monetar, i njëjti është edhe i pariparueshëm. Kjo ngase, ashtu siç dihet në strukturat e financimit dhe instrumentet financiare për financimin e projekteve kapitale të tilla investuese është jashtëzakonisht e komplikuar, e posaqerisht kur merret për bazë se një pjesë e madhe e investimit është financuar nga bankat Komerciale ne Kosove me kredi hipotekare, përmes hipotekave kreditore. Ne rast se nuk fillohet me kthimin e mjeteve te investuara për një periudhë qe nga muaji i parë i pezullimit e deri ne tre (3) vite kjo do te rezultonte ne pamundësinë financiare për te mbijetuar për Kompaninë e me këtë edhe do te rrezikohet kthimi i kredive me c' rast bankat do te fillojnë me realizimin e kërkesave te tyre përmes procedurave përmbaruese me c' rast do te shiten edhe pasurit (shtëpitë ku jetojmë) te lëna me hipotek-Hidoenergji do të kanosej seriozisht ne likuidim".*

79. Në vijim, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe parimit të pritjes legjitime, për të cilin thekson se: " *[dispozitat e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së] nuk mund t'ia*

dobësoj te drejtën shtetit për te sjell ligje qe vlerësohen si te nevojshme për te kontrolluar përdorimin e pronës ne përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e tatimit ose kontributeve tjera dhe gjobave". Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar rastit *Lonnroth kundër Suedisë* thekson se: *"GJEDNJ-ja ka vendosur tri (3) parime bazë, qe aplikohen sa i përket intervenimit/kufizimit te se drejtës ne prone sipas Nenit 1 te Protokollit 1 te KEDNJ-se, dhe ato janë si ne vijim: i) Parimi i ligjshmërisë;(ii) parimi i ekzistimit te qëllimit legjitim ne mbrojtjen e interesit publik dhe (iii) parimi i një baraspeshe te drejt ne mes te mbrojtjes se interesit publik dhe te drejtës ne prone te personit te caktuar proporcionaliteti)".*

80. Parashtruesi i kërkesës specifikon se ndërhyrja në të drejtën e pronës mund të justifikohet vetëm *"nëse është i mbështetur me ligj [i referohet rastit të GJEDNJ-së Saliba kundër Maltës]; është i mbështetur në një qellim legjitim e qe është ne interes publik ose te përgjithshëm dhe kufizimi i kësaj të drejte duhet të jetë i bazuar në parimin e proporcionalitetit, përkatësisht - të mos privohet askush po qe se ndërmjet mjeteve dhe masave tjera (te lehta) mund të arrihet mbrojta e interesit të përgjithshëm".*

81. Duke iu referuar rastit të GJEDNJ-së, *Capital Bank AD kundër Bullgarisë,* parashtruesi i kërkesës shton: *"GJEDNJ në rastin Capital Bank AD kundër Bullgarisë, ka gjetur se kriteri i ligjshmërisë, supozon, ndër të tjera që ligji vendor duhet të ofroj mekanizëm për mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga ana e autoriteteve publike. Më tutje, Gjykata thekson se "koncepti i ligjshmërisë dhe i sundimit të ligjit në shoqëri demokratike kërkon që masat të cilat afektojnë të drejtat e njeriut, të mund të jenë objekt shqyrtimi para organeve të pavarura gjyqësore". Andaj, sipas GJEDNJ-së, "çdo ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës duhet të përcjellët me garanci procedurale që i mundësojnë individëve apo subjekteve juridike që të prezantojnë rastin e tyre para autoriteteve përgjegjëse në mënyrë që të sfidojnë seriozisht hapat me të cilat është ndërhyrë në të drejtat e garantuara sipas kësaj dispozite".*

82. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 119. 4 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që obligon Republikën e Kosovës që të promovojë mirëqenie dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm sepse: *"Marrë parasysh kapacitetet energjetike ekzistuese të Republikës së Kosovës, dhe faktin se përveç mungesës së theksuar të kapaciteteve prodhuese, edhe kriza globale energjetike, dhe rritja enorme e çmimeve të importit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 119, paragrafi 4, pasi që ky Aktgjykim dekurajon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik."*

83. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe mungesën e arsyetimit bindës të Gjykatës Supreme, nuk ka pasur garanci të mjaftueshme ndaj arbitraritetit të Gjykatës Supreme çka ka rezultuar me shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(iv) Pretendimi për caktim të masës së përkohshme

84. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se ai ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës.

85. Së dyti, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *"Zbatimi i Aktgjykimit te Gjykatës Supreme ne Lidhje me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit dhe te Gjykatës Themelore ne Prishtine për Çështje Administrative, do te shkaktoj dëm të paripareushëm material dhe jo -material për parashtruesin e Kërkesës, pasi qe ai do te privohet nga e drejta*

ne ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme bazuar në Lejen Ujore dhe Lejen Mjedisore të dhënë nga organet administrative, pa iu ofruar atij në çështjen e konfliktit administrativ në procedure të drejt që i garantohet me Kushtetutë, duke vënë në pikëpyetje sigurinë juridike për të gjithë qytetaret dhe vetë parashtruesin".

86. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Çmimi për energji elektrike që gjenerohet nga hidrocentralet sipas Vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë V 810/2016, është 67.47 EUR për MWh. Dëmi që i shkaktohet parashtruesit të kërkesës nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar është i pariparueshëm, ngase energjia elektrike që do të mund të prodhohej në këtë periudhe kohore, nuk mund të zëvendësohet me energjinë elektrike e cila do të prodhohet në të ardhmen. Thënë thjeshtë, fitimi që do të mund të realizohej nga gjenerimi-e rrjedhimisht shitja e energjisë elektrike nga ana e Parashtruesit të Kërkesës për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) nuk mund të kompensohet nëpërmjet një prodhimi më të madh që do të mund të ndodhte në të ardhmen".*

87. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme sjellë pasoja "substancialisht" të dëmshme për interesin publik.

88. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar nenit 10 te Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, që flet për të drejtën e investitorëve që t'iu drejtohen gjykatave për kompensim të dëmit në rast të shkeljes së ligjit në dëm të tyre, pretendon: *"Po ashtu edhe me Kontratën për Blerje te Energjisë e lidhur me ndërmarrjen shtetërore KOSTT ne pronësi te shtetit te Kosovës, është e përfshirë klauzola parashtruesi i kërkesës ka te drejt te garantuar ti drejtohet Arbitrazhit ne Londër. Rasti ne fjale është duke u vëzhguar me kujdes nga investor te mëdhenj nga e gjithë Europa, dhe vendimet e tilla te gjykatave te rregullta përmes masave te përkohshme pa gjykim te drejt do te dëmtojnë zhvillimin dhe do te dëmtohet interesi i përgjithshëm ne Kosovë".*

89. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se kompania e tij: *"...ka investuar më shumë se 16 milion euro, duke i përmbushur te gjitha kushtet teknike, mjedisore dhe ato komerciale. Ka kryer çdo studim te mundshëm dhe ka realizuar edhe Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis, ku pas zhvillimit te Debateve Publike me qytetar nga Ministria e Mjedisit është pajisur me Vendimin për Pëlqimin Mjedisor d.m.th. para se te pajiset me Leje ndërtimore dhe te ndërton projektin, i cili pasi është komisionuar është pajisur me certifikata te përdorimit Leje Ujore, leje Mjedisore(sipas Kushteve te Pëlqimit Mjedisor) dhe Licence për prodhimin e energjisë elektrike, te gjitha këto kushte janë përmbushur sipas legjislacionit ne fuqi dhe janë lëshuar nga institucionet relevante te autorizuar me ligj për lëshimin e tyre".*

90. Lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të:

    (i) LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatjen e caktuar nga Gjykata; dhe
    (ii) TË SUSPENDOJË menjëherë zbatimin e Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] të 19 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktvendimit [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [A. nr. 3129/2020] të 12 prillit 2022, të Gjykatës Themelore.

91. Në vijim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

    (i) TË SHPALL kërkesën të pranueshme;
    (ii) TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së;

(iii) TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1. të KEDNJ-së;
(iv) TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ. UZVP. nr. 51/2022 të 19 korrikut 2022 dhe Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin[A. nr. 3129/2020] të 12 prillit 2022, të Gjykatës Themelore;
(v) TË KTHEJË Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës; dhe
(vi) TË LEJOJË masën e përkohshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës të rivendos për çështjen.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]."

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1.E drejta e pronës është e garantuar.
2.Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3.Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E Drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri dëmokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 1
(Mbrojtja e pronës)

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 6
(Parimi i shqyrtimit verbal)

"Në konfliktin administrativ, gjykata vendosë në bazë të shqyrtimit verbal, të drejtpërdrejt dhe publik."

Neni 10
(Pa titull)

1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.

2. Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.

3. Organi ka të drejtë të iniciojë konfliktin administrativ, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, nëse ai/ajo konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij.

4. Nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në favor të personit fizik, personit juridik, konfliktin mund ta iniciojë prokurori publik kompetent ose organi tjetër i autorizuar me ligj. Organet e administratës kanë për detyrë që, kur të kenë mësuar për to, të njoftojnë prokurorin publik kompetent ose organin e autorizuar me ligj.

5. Konfliktin administrativ mund ta iniciojë edhe prokurori publik kompetent ose personi i autorizuar nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në dëm të organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të tjera në varësi të tyre, të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të organeve në varësi të tyre, kur janë shkelur të drejtat pronësore të këtyre organeve.

Neni 22
(Pa titull)

1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.
4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.

5. Organi nga paragrafi 2. i këtij neni mund të shtyjë ekzekutimin e aktit të kontestuar edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse nuk është në kundërshtim me interesin publik.
6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.
7. Për kërkesën, gjykata vendos brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 63
(Dispozita të tjera të procedurës)

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

LIGJI NR. 03/l-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 160
(Pa titull)

160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.
160.2Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.
160.3Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimine kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.
160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.
160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.
160.6 Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit kontumacional, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsyet që e justifikojnë dhënien e aktgjykimeve të këtilla.

Neni 175

(Pa titull)

"Dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 paragrafi 2 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kem të bëjmë me aktvendimet."

Neni 194
(Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë)

"Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji."

LIGJI Nr. 05/L-081 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

Neni 15
(Caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme)

1. Qeveria i cakton caqet vjetore dhe afatgjata të energjisë së ripërtërishme për konsum të energjisë elektrike, të energjisë termike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi, si dhe të energjisë nga burime të ripërtërishme që shfrytëzohet në transport. Qeveria do ta miratojë planin shtetëror të veprimit për energji të ripërtërishme për arritjen e cakut që 25% e konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 të mbulohet nga energjia e ripërtërishme. Plani shtetëror i veprimit për energji të ripërtërishme, pas miratimit do t'i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
2. Me arritjen e cakut të mbulimit të 25% të konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 nga energjia nga burimet e ripërtërishme, Kosova do të mund t'i qaset mekanizmave bashkëpunues me Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë apo me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Korniza e këtij mekanizmi bashkëpunues do të miratohet nga Qeveria me akt të veçantë nënligjor.
3. Caqet afatgjate të energjisë së ripërtërishme hartohen për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, në pajtim me metodologjinë e përcaktuar me akte nënligjore, të miratuar nga Ministria.
4. Ministria përgatit dhe nxjerrë akte nënligjore që përfshijnë masat që synojnë përmbushjen e caqeve të energjisë së ripërtërishme dhe propozimet e tilla marrin parasysh si në vijim:
4.1. parimet e tregut konkurrues të energjisë; dhe
4.2. karakteristikat e llojeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.
5. Ministria harton dhe publikon raportin mbi realizimin e caqeve vjetore afatgjate për burimet e ripërtërishme të energjisë si pjesë e raportit mbi zbatimin e Planit shtetëror të Veprimit për Energji të Ripërtërishme dhe Programit për Strategjinë sipas nenit 7 paragrafi 7 këtij ligji. Raporti duhet të përfshijë një analizë të progresit për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë, veçanërisht duke marrë për bazë ndikimin e faktorëve klimatikë. Kjo analizë paraqet shtrirjen e masave për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe masat e mundshme përmirësuese për të qenë në rrugë të mirë në arritjen e caqeve të tilla.
6. Rregullatori certifikon prejardhjen e energjisë të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë sipas kritereve objektive, transparente dhe jodiskriminuese në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
7. Institucionet e përfshira në promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë do të sigurohen se informatat mbi masat përkrahëse do t'i vëhen në dispozicion të gjithë

akterëve relevantë, siç janë: konsumatorët, ndërtimtarët, instaluesit, arkitektët dhe furnizuesit e pajisjeve të ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike që shfrytëzojnë energji nga burimet e ripërtërishme.
8. Autoritetet lokale dhe rajonale do të sajojnë programe përkatëse informative, vetëdijësuese, udhëzuese dhe trajnuese, me qëllim të informimit të qytetarëve mbi përfitimet dhe praktikalitetet e zhvillimit dhe shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS

Neni 70
(Fitimi dhe kushtet e fitimit të së drejtës ujore)

1. Fitimi i së drejtës ujore, sigurohet:
1.1. me leje ujore;
1.2. me koncesion.
2. Bartësi i të drejtës ujore shfrytëzon ujin sipas kritereve të përcaktuara me aktin për fitimin e së drejtës ujore.
3. Koncesioni, përkatësisht partneriteti publik dhe privat kryhet në kushte, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave të caktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 71
(Procedurat për lëshimin e lejes ujore)

1. Procedura për fitimin e lejes ujore është:
1.1. Kushtet ujore;
1.2. Pëlqimi ujor;
1.3. Leja ujore.
1.4. Urdhëresa Ujore
2. Procedura për kushtet ujore, pëlqim ujor, leje ujore dhe urdhëresë ujore do të rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 72
(Leja ujore)

1. Leja ujore lëshohet për:
1.1. nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm;
1.2. shkarkim të ujërave të ndotura;
1.3. ndërtimin, rindërtimin ose dëmolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujor; 1.4.aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave;
1.5. për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave;
1.6. eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit;
1.7. përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale; dhe
1.8. aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujor.
2. Leja ujore nuk është e nevojshme për: shfrytëzimin e puseve, burimeve, cisternave dhe objekteve të ngjajshme për furnizimin e një amvisërie me ujë të pijshëm, fikjen e zjarreve dhe ndërmarrjen e masave urgjente sanitare dhe masave tjera në rast të rrezikut të përgjithshëm.
3. Me Lejen Ujore përcaktohet destinimi, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujit, shkarkimi i ujërave të ndotura, regjimi i punës së objekteve dhe impianteve, deponimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta si dhe kushtet tjera.

4. Leja Ujore, sipas këtij ligji, për shfrytëzimin e ujërave ndërkufitare dhe shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat ndërkufitare jepet në pajtim me marrëveshjen ose konventën ndërkombëtare.
5. E drejta e shfrytëzimit ose shkarkimit të ujërave të ndotura, e fituar në bazë të lejës ujore, nuk mund të bartet në persona tjerë, pa pëlqimin e autoritetit kompetent.
6. Ministria lëshon lejet ujore me akt nënligjor, Ministria mund të delegojë kompetenca për të cilat komunat dhe Autoriteti, mund të lëshojnë leje ujore.
7. Leja Ujore rishqytohet së paku në çdo pesë (5) vjet.
8. Bartësi i të drejtës ujore, detyrohet t'a informojë lëshuesin e lejës, në rast të ndryshimit në veprim, teknologji dhe shfrytëzim të ujit apo në raste tjera, kur mund të kenë ndikim të rëndësishëm në regjimin ujor.

LIGJI Nr. 03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 31
(Leja Mjedisore)

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.
2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.
3. Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MZHE) Nr. 05/2017
CAQET E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME [MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
(aprovuar më 23 qershor 2017)

Neni 3
(Caku obligativ dhe indikativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme)

1.Shprehjet specifike që përdoren në këtë Udhëzim Administrativ kanë domethënie si në vijim:
1.1. Caku obligativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2020, është 25% i konsumit përfundimtar bruto te energjisë ,siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimet të Këshillit Ministror te Komuniteti te Energjisë Nr.D/2012/04/MC-EnC;

[...]

1.3. Caku indikativ i energjisë nga burimet e ripërtëritshme për vitin 2020 është 29.89% e konsumit përfundimtar bruto të energjisë;

[...]

UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH-NR 03/2018 PËR PROCEDURAT PËR LEJE UJORE [MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR]
(miratuar më 24 gusht 2018)

II.3 Leja Ujore

Neni 15
(Sigurimi i Lejes Ujore dhe Dokumentacioni)

1.Leja ujore sigurohet për të gjitha objektet edhe aktivitetet me të cilat me dispozita ligjore është përcaktuar lëshimi i pëlqimit ujorë, me përjashtim të nxjerrjes së materialit nga ujë rrjedhat dhe rregullimi i ujë rrjedhave dh ujërave të tjera

[...]

Neni 17
(Kohëzgjatje dhe vazhdimi i lejes ujore)

1.Kohëzgjatja e lejes ujore është rregulluar me nenin 73të Ligjit.
[...]

UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH-NR 07/2017 PËR LEJE MJEDISORE [MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR] (miratuar më 9 qershor 2017 dhe i shfuqizuar me Udhëzimin Administrativ MMPH 04/2022 për Leje Mjedisore të 3 qershorit 2022)

Neni 11
(pa titull)

1. Në bazë të propozim vendimit të komisionit, Ministria e lëshon apo e refuzon kërkesën për Leje Mjedisore në afat prej 15 ditësh dhe për vendimin e marrë e njofton me shkrim aplikuesin dhe Komunë/Komunat.
2. Nëse operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore i lëshohet Leja Mjedisore.
[...]
4.Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pese (5) vjeçare.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

92. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

93. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 21

"[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

Neni 113

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

94. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

95. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës nr. KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe nr. KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand,* Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

96. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ.UZVP. nr. 51/2022 të 19 korrikut 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

97. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret janë të aplikueshëm neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkatësisht, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës, e cila ndërlidhet me procedurën paraprake gjyqësore për pezullimin apo shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për lëshimin e lejes ujore dhe lejes mjedisore, në kuptim të

pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës së tij në pronë është *ratione materiae* me Kushtetutën.

Në lidhje me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në procedurë paraprake

98. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, duke marrë parasysh që vendimet e kontestuara ndërlidhen me vendime përkitazi me masa të sigurisë, përkatësisht "*procedura paraprake*", Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), duhet të vlerësojë aplikueshmërinë e garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

99. Prandaj, në kontekst të kësaj të fundit, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit, është i rëndësishëm sepse procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta hyjnë në fushëveprimin e *"procedurave paraprake"*, përkatësisht Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ndërlidhet me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve për lejeve mjedisore të lëshuara nga MEA-ja dhe licencave për prodhim të energjisë elektrike të lëshuara nga ZRRE-ja, derisa padia për anulimin e vendimeve të MEA-së dhe ZRRE-së derisa gjykata themelore të vendos me vendim përfundimtar (shqyrtim të meritave) lidhur me padinë e palëve paditëse. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

100. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikes së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretoje të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

101. Gjykata vë po ashtu në pah, se kriteret për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me procedurat paraprake janë përcaktuar po ashtu edhe në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI122/17, parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018; KI150/16; parashtrues, *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; KI81/19; parashtrues, *Skender Podrimqaku*, Aktvendim për papranueshmëri i 9 nëntorit 2019; KI107/19; parashtrues, *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020; KI195/20 parashtrues, *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021; dhe KI202/21, me parashtrues *Kelkos Energy SH.P.K.*, Aktgjykim, i 29 shtatorit 2022. Parimet e përgjithshme të vendosura përmes vendimeve të lartcekura të Gjykatës janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.

102. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse në rastin konkret aplikohet neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do t'iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

103. Bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë apo masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ përcaktoi

kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në *"proceduarat paraprake"* (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).

104. Sipas kritereve të përcaktuar në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kritere edhe kjo Gjykatë i ka pranuar përmes praktikës gjyqësore, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë *"civile"* si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe; së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 84 dhe 85 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës KI122/17, parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafët 130 dhe 131; KI81/19, parashtrues, *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafët 47 dhe 48; KI107/19, parashtrues, *Gafurr Bytyqi*, të cituar më lart, paragrafi 53).

105. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit parashtruesi i kërkesës i referohet vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit për leje ujore, të 5 qershorit 2020 dhe vendimit Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për leje mjedisore të 26 qershorit 2020, respektivisht (në tekstin e mëtejmë: Vendimet e Ministrisë përgjegjëse për ambient). Paditësit/propozuesit kishin inicuar konflikt administrativ duke parashtruar padi administrative në Gjykatën Themelore më 30 dhjetor 2021, dhe njëkohësisht të njëjtit kishin paraqitur edhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të lartcekura me arsyetimin se hidrocentralet e ndërtuara në territorin e komunës së Kaçanikut e dëmtojnë cilësinë e ujit të pijes dhe të ujitjes. Shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara si masë e përkohshme bazuar në dispozitat e LKA-së do të nënkuptonte pezullimin e prodhimit të energjisë elektrike nga parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet Hidrocentralit Lepenci 3 në komunën e Kaçanikut, deri në marrjen e vendimit meritor lidhur me çështjen nga Gjykata Themelore.

106. Rrjedhimisht, kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve administrative, si në rrethanat e rastit konkret, në procedurë të konfliktit administrativ është paraparë në nenin 22 të LKA-së. Ky vendim për shtyrje të ekzekutimit, bazuar në ligjin e aplikueshëm, mund të merret deri në vendosjen në merita të rastit nga gjykatat e rregullta. Pajisja e parashtruesit të kërkesës me leje ujore dhe leje mjedisore nga Ministria përkatëse ndërlidhet me: **(i)** ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentraleve si burim i ripërtërishëm për prodhimin e energjisë elektrike në territorin e komunës së Kaçanikut; dhe, **(ii)** parashtruesi i kërkesës qysh nga qershori i vitit 2019 ka filluar me gjenerimin e energjisë elektrike gjeneruese nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës për hidrocentrale.

107. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës:

(i) gëzon në mënyrë të pakontestueshme një të "drejtë civile" që vë në lëvizje garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;
(ii) kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është *ratione materiae* në pajtim më Kushtetutën; dhe, se
(iii) garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshme në rastin e tij.

Konkluzion në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës

108. Në fund dhe pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet as si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

109. Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme bazuar në lejet ujore dhe mjedisore të lëshuara nga Ministria përkatëse për Mjedis, të cilat i kanë mundësuar parashtruesit të kërkesës investimin nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës për hidrocentrale. Ndërkohë paditësit/propozuesit kishin inicuar konflikt administrativ duke parashtruar padi ndaj Ministrisë përgjegjëse për Mjedis, me ç' rast kishin paraqitur kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të kontestuara për lëshimin e lejeve ujore dhe mjedisore të kësaj Ministrie. Gjykata Themelore kishte aprovuar si të bazuar propozimin e paditësve/propozuesve dhe vendosi që të shtyhet ekzekutimi i vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis, përkatësisht lejes ujore dhe asaj mjedisore, derisa Gjykata Themelore të vendos me vendim përfundimtar përkitazi me padinë. Parashtruesi i kërkesës duke qenë palë me interes në këtë çështje paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit fillimisht vendosi që të aprovojë si të bazuara ankesën e parashtruesit dhe Ministrisë përgjegjëse për mjedis, duke e kthyer çështjen në rivendosje për shkak të shkeljeve të procedurës kontestimore dhe asaj administrative. Gjykata Themelore në procedurë të rivendosjes sërish vendosi që të aprovojë si të bazuar propozimin e paditësve/propozuesve dhe të shtyjë ekzekutimin e vendimeve për lëshimin e Lejes Ujore të 5 qershorit 2020 dhe Lejes Mjedisore të 26 qershorit 2020. Parashtruesi i kërkesës dhe Ministria përgjegjëse për Mjedis sërish paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022 refuzoi ankesën e tyre si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të 12 prillit 2022. Si rrjedhojë e kësaj, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë në Gjykatës Supreme, përkatësisht dy Aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar të saj të 19 korrikut 2022 kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

110. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka ngritur pretendime: (i) për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të shkeljes së të drejtës së tij për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe zbatim qartazi të gabuar të ligjit, përkatësisht nenit 22 të LKA-së; dhe (ii) për shkelje të së drejtës së tij në pronë. Në fund, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij ka ofruar arsyetim në lidhje me kërkesën e tij për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

111. Gjatë vlerësimit të meritave të këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

112. Në vijim, Gjykata do të fillojë me shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së,.

I.Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

A. Vlerësimi i pretendimit për mungesë të vendimit të arsyetuar

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

113. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.

114. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).

115. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).

116. Neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim, i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).

117. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih rastet e GJEDNJ *Ruiz Torija kundër Spanjës*, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).

118. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 28).

119. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:

(a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe

(b) të shqyrtojnë me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, 16574/08, Aktgjykim, i 7 shkurtit

2013, paragrafi 72; *Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut*, nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).

120. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).

121. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykatë më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës* (nr. 2), nr. 47628/06, Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; *Bufferne kundër Francës*, nr. 54367/00, Vendimi i 26 shkurtit 2002),

122. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, gjykata e apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

123. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).

124. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Mugoša kundër Malit të Zi*, nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

(ii) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

125. Lidhur me pretendimin për një vendim të arsyetuar, Gjykata rikujton kushtet ligjore që duhet plotësuar për shtyrjen e ekzekutimit të një akti deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas nenit 22, paragrafi 2 të LKA-së i cili përcakton se: *"Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar".*

126. Gjykata vëren se sipas dispozitave relevante të cekura më lart, për shtyrjen ekzekutimit të një akti, është e nevojshme të plotësohen këto kushte:

(i) nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse;
(ii) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe
(iii) as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

127. Në tekstin e mëposhtëm të këtij Aktgjykimi, Gjykata do të ballafaqojë pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në procedurë para Gjykatës Supreme dhe përgjigjen e kësaj të fundit në raport me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

128. Në këtë drejtim, Gjykata sërish vë në dukje pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm gjyqësor, të parashtruara në Gjykatën Supreme, që ishin si në vijim: (i) kushtet kumulative të përcaktuar me nenin 22 nuk janë plotësuar në rrethanat e rastit konkret; (ii) nuk janë vërtetuar fare faktet vendimtare, dhe nuk janë marra për bazë asnjë prove materiale e tij, gjegjësisht dëshmitë dhe provat që ndërlidhen me atë se vendimet për Lejen Ujore dhe Lejen Mjedisore janë nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi; (iii) se shtyrja e tillë do të ketë pasoja për interesin publik, gjegjësisht furnizimin me energji; dhe (iv) gjykatat e shkallës më të ulët janë mbështetur në perceptimin e opinionit publik, gjegjësisht të paditësve/propozuesve se janë duke i mbrojtur të drejtat e qytetarëve.

129. Gjykata i referohet arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit theksohet se: *"Duke pasur parasysh dispozitat e paraqitura sipër të Ligjit për konfliktet administrative, kjo gjykate ka gjetur se gjykata e shkalles se dyte ka vepruar drejt kur ka refuzuar si te pabazuara ankesat e te paditurës - Ministrisë se ambientit, planifikimit hapësinore, infrastrukturës dhe palës së interesuar "Hidroenergji"sh.p.k Lepenci 3, të parashtruara kundër aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine - Departamenti për Çështje Administrative A. U .nr.3129/2021 dt.12.04.2022, me te cilin është aprovuar si i bazuar propozimi i propozuesve - paditësve organizatës joqeveritare "Grupi për studime juridike dhe politike" dhe organizatës joqeveritare "Gjeti" për shtyrje të ekzekutimit te vendimit te paditurës nr. 6724-2/199 dt. 05.06.2020 dhe vendimit nr. 1948-4/19 dt 26.06.2022 deri ne nxjerrjen e aktgjykimit te shkalles se pare sipas padisë se paditësve.*
Vendimet e tilla të gjykatave të instancës më të ulët kanë rezultuar nga provat në shkresa të lëndës, ngase sipas mendimit të kësaj gjykate zbatimi i vendimeve të paditurës të kontestuara me padi, paraqet rrezik te shkaktimit te dëmit paditësve i cili vështirë do të riparohej nëse merret parasysh shkaktimi i dëmit mjedisit jetësor që do të mund t'i shkaktohej të njëjtit, degradimit potencial të natyrës dhe të veçorive të saja si dhe të ekuilibrit të përgjithshëm te natyrës.
[...]
Sipas mendimit të kësaj gjykate, paditësit – propozuesit përmes padisë dhe provave të bashkëngjitura me padi, kanë ofruar prova bindëse me të cilat vërtetohen faktet se ekzekutimi i vendimeve do të sillte dëm qytetareve të cilët jetojnë në pronat tyre dhe jetojnë në atë mjedis ku është parapare puna e këtyre hidrocentraleve, me çfarë do të shkaktohej dëm i pa kompensueshëm atyre.

Poashtu, kjo gjykatë ka gjetur se ekzekutimi i vendimeve deri në nxjerrjen e vendimit meritor nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe as shtyrja nuk do të sillte ndonjë humbje më të madhe palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Ne këtë mënyrë do të shmangeshin pasojat e mundshme në të ardhmen në rast se do të vërtetohej se vendimet e kontestuara të paditurës, në fund te procesit gjyqësor do të rezultonin në kundërshtim me ligjin. Duhet po ashtu të theksohet që sipas mendimit të kësaj gjykate, shtyrja e ekzekutimit të vendimit të paditurës me

asgjë nuk mund të prejudikohet, ngase bëhet fjalë për një vendim të përkohshëm, gjegjësisht i njëjti vlen deri në nxjerrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkalles së parë sipas padisë së paditësit.

Nisur nga kjo që u parashtrua, Gjykata Supreme ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje juridike -- administrative ka aplikuar drejtë dispozitat e procedurës administrative dhe të kontestit administrativ, dhe se pretendimet në kërkesën e palës së interesuar "Hidroenergji" sh.p.k Lepenci për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësore janë të pabazuara, ngase nuk janë me ndikim për vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkalles së dytë. Sipas vlerësimit të gjykatës, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkalles së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetim të aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të palës së interesuar "Hidroenergji" sh.p.k Lepenci 3 apo të paditurës."

130. Bazuar në këtë arsyetim të Gjykatës Supreme si më lart, Gjykata vëren se kjo e fundit bazohet në pretendimet e paditësve, përderisa nuk ka adresuar pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës apo ka ofruar ndonjë argument specifik në lidhje me provat e paraqitura nga ana e tij. Përderisa në të njëjtën kohë Gjykata vëren se Gjykata Supreme në kuptim të interpretimit dhe zbatimit të nenit 22 të LKA-së në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se: *"kanë ofruar prova bindëse me të cilat vërtetohen faktet se ekzekutimi i vendimeve do të sillte dëm qytetareve të cilët jetojnë në pronat tyre dhe jetojnë në atë mjedis ku është parapare puna e këtyre hidrocentraleve, me çfarë do të shkaktohej dëm i pa kompensueshëm atyre".*

131. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme nuk kishte dhënë shpjegim ndaj pretendimeve qendrore për rastin e parashtruesit të kërkesës, siç kërkohet me garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, përfshirë saktësimin e përmbushjes së kritereve të përcaktuara me nenin 22 të LKA-së, përpos që u është referuar në mënyrë të përgjithësuar.

132. Thënë ndryshe, Gjykata Supreme nuk ka shpjeguar:

(i) raportin ndërmjet paditësve/propozuesve dhe parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht nuk ka shpjeguar raportin ndërmjet dëmit të pariparueshëm për paditësit/propozuesit dhe dëmit të pariparueshëm për parashtruesin e kërkesës;

(ii) përse shtyrja e ekzekutimit të vendimeve për lëshimin e lejeve ujore dhe mjedisore është në mbrojtje të interesit publik dhe nuk është në mbrojtje të interesit publik nëse do të lejohej ekzekutimi i vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për mjedis duke marrë për bazë atë se hidrocentralet prodhojnë energji nga burimet e ripërtëritshme; dhe

(iii) nuk ka dhënë asnjë shpjegim përse interesi i paditësve/propozuesve është edhe interes publik dhe përse e njëjta nuk vlen edhe për parashtruesin e kërkesës.

133. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk ka pranuar përgjigje ndaj pretendimeve thelbësore, Gjykata vlerëson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i ofron garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së që ngërthejnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës,* cituar më lart, paragrafi 53; si dhe shih rastet e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* cituar më lart, paragrafi 139 dhe KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring,* cituar më lart, paragrafi 44 dhe rastin KI202/21, me parashtrues *Kelkos Energy*, SH.P.K., të cituar më lart, paragrafi 134).

134. Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka përcaktuar se gjykatat me juridiksion apeli nuk kanë nevojë të japin arsyetim të detajuar në rastet kur pajtohen me arsyetimin e dhënë nga gjykata e instancës së parë, përkundër faktit që të njëjtat po ashtu duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara (shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 31). Mirëpo, në rrethanat e rastit nën shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme vetëm ka vërtetuar aktvendimet e gjykatave të shkallës më të ulët duke aprovuar edhe qëndrimin dhe arsyetimin e tyre në këto aktvendime.

135. Rrjedhimisht, duke marrë për bazë atë që edhe Gjykata Supreme nuk adresoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, pretendime të cilat ai i kishte ngritur edhe para Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, Gjykata vlerëson se kriteret thelbësore të së drejtës për një vendim të arsyetuar-në një mënyrë ose tjetrën-përcaktojnë se Gjykata Supreme ka pasur për obligim që t'i adresojë pretendimet qendrore të parashtruesit të kërkesës dhe jo që t'i shpërfillë ato në tërësi ose që disa prej tyre t'i adresojë vetëm me një arsyetim të shkurtër dhe të përgjithësuar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e KI202/21, me parashtrues *Kelkos Energy*, SH.P.K., i cituar më lart, paragrafi 135).

136. Nga sa më sipër, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme ka pasur për obligim që t'i adresojë çështjet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, çka në rrethanat e rastit konkret nuk ka ndodhur.

137. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis ka aprovuar dhe vërtetuar qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët, duke theksuar se paditësit/propozuesit kanë ofruar "prova bindëse" të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimeve të lartcekura për lëshimin e lejeve ujore dhe mjedisore deri në vendosjen meritore të çështjes, do t'iu shkaktonte dëm të pariparueshëm pa ofruar arsyetim dhe shtjellim të "provave bindëse" që do të provonin se përse ato kushte ligjore ishin plotësuar në rastin konkret.

138. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme përtej përshkrimit të dispozitave ligjore dhe konstatimit se kushtet e lartpërmendura janë plotësuar nuk ka shpjeguar se: (i) cili është dëmi që i shkaktohet paditësve/propozuesve nga ekzekutimi i vendimeve të kontestuara dhe pse ai dëm është i pariparueshëm; (ii) cilat prova janë vlerësuar e konstatuar se shtyrja e vendimeve të Ministrisë për dhënien e lejes ujore dhe asaj mjedisore nuk është në kundërshtim me interesin publik; (iii) pse parashtruesit të kërkesës nuk i shkaktohet ndonjë dëm, meqenëse ai ka pretenduar se i shkaktohet dëm dhe ka argumentuar përmes provave këtë pretendim; dhe (iv) vendimi i Gjykatës Supreme nuk përmban fare arsyetim lidhur me pretendimet qendrore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

139. Në fund, Gjykata rithekson se drejtësia procedurale kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur, posaçërisht nëse kanë të bëjnë me pretendimet vendimtare që në rastin konkret i referohen fakteve vendimtare dhe kushteve ligjore lidhur me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë (shih rastin e Gjykatës KI202/21, *Kelkos Energy*, SH.P.K., i cituar më lart, paragrafi 140).

140. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk i plotëson kriteret e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar.

B. Vlerësimi i pretendimit për interpretim të gabuar të ligjit

141. Gjykata fillimisht rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili në kuptim të kritereve të përcaktuar me nenin 22 të LKA-së për shtyrje të ekzekutimit të vendimit thekson se duhet të plotësohen tri (3) kushte, përkatësisht: (a) me ekzekutimin e vendimit paditësit do t'i shkaktohej dëm që vështire do të riparohej; (b) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe (c) shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare apo personit të interesuar.

142. Sipas parashtruesit të kërkesës asnjëri nga këto tre (3) kushte nuk janë plotësuar, dhe në lidhje me këtë të fundit ai pretendon se në rastin konkret Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Suprem është i përfshirë me interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit.

143. Gjykata fillimisht vë në dukje se në mbështetje të pretendimit të tij për interpretimi dhe zbatim të gabuar të dispozitave të LKA-së, parashtruesi i kërkesës ngritë ndër të tjera çështje që ndërlidhen me mungesë të arsyetimit të vendimit apo mungesë të dhënies së arsyetimit nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me plotësimin e secilit kriter të përcaktuar në nenin 22 të LKA-së. Në lidhje me pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata tashmë ka konstatuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ka respektuar standardin e një vendimi të arsyetuar gjyqësor ashtu siç është përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, praktikë kjo e afirmuar edhe përmes vet praktikës gjyqësore të Gjykatës.

144. Prandaj, Gjykata duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret, gjegjësisht pretendimet e ngritura nga ana e parashtruesit të kërkesës në parashtresat e tij para gjykatave të rregullta dhe përpara vet Gjykatës, pretendimin e tij për interpretim dhe zbatim qartazi të gabuar të ligjit do ta shqyrtojë në dritën e konstatimeve të Gjykatës në lidhje me arsyetimin e Gjykatës Supreme e që ndërlidhen me plotësimin e kritereve të përcaktuar me nenin 22 të LKA-së. Thënë këtë, Gjykata do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse interpretimi dhe zbatimi i gabuar i nenit 22 të LKA-së ka rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës.

145. Gjatë elaborimit të pretendimit të lartcekur që ndërlidhej me shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës si rezultat i "interpretimit dhe zbatimit qartazi të gabuar te ligjit", ajo do t'i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme

146. Duke u ndërlidhur me pretendimet në rastin konkret, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, ne parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj,* Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017; KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues te kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60; KI119/19, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)*, Aktvendimin për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 58).

147. Megjithatë, Gjykata, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky

qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht e në rrethanat konkrete gjykatat, kane detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit; roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në pajtueshmëri me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe te tjerët kundër Spanjës*, kërkesa nr. 38366/97 dhe 9 të tjera, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; si dhe shih rastin e Gjykatës KI119/19, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)* Aktvendimin për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 61). Rrjedhimisht, Gjykata ka theksuar se është kryesisht roli i gjykatave të rregullta që të merren me çështjen e interpretimit të ligjit, përderisa roli i Gjykatës Kushtetuese është që të verifikojë nëse pasojat e një interpretimi të tillë janë në pajtim me Kushtetutën (shih rastin e cituar më lart KI75/17, parashtrues *X*, paragrafi 58).

148. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim, i 11 janarit 2007, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesa nr. 184/02 Aktgjykim, i 11 janarit 2007, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, Aktgjykim, i 1 dhjetorit 2005, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, Aktgjykim, i 25 korrikut 2007, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], i cituar më lart, paragrafi 108; shih gjithashtu, rastin e cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; rastet KI154/17 dhe 05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65; si dhe rastin KI121/19, parashtrues *Ipko Telecomunications*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 58, dhe referencat e përdorura aty).

(ii) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

149. Gjykata tashmë ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mungesës së arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Gjykata në vijim, do të shqyrtojë nëse parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i interpretimit qartazi të gabuar të ligjit. Gjatë aplikimit të parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të marrë për bazë edhe atë nëse mungesa e arsyetimit të vendimit gjyqësor ka ndikuar në interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit, e cila për pasojë mund të ketë rezultuar në konkluzione arbitrare.

150. Në vijim, Gjykata ripërsëritë se bazë specifike ligjore në procedurën paraprake të zhvilluar në kuadër të procedurës administrative, e iniciuar sipas kërkesës së paditësve/propozuesve është neni 22, paragrafët 2 dhe 6 të LKA-së, të cilat dispozita përcaktojnë kriteret që duhet plotësuar në mënyrë që gjykata të lejojë shtyrjen e ekzekutimit të një vendimi administrativ, siç është rasti me Vendimet e Ministrisë përkatëse për Mjedis për lëshimin e lejes ujore, të 5 qershorit 2020 dhe Vendimin për Lëshimin e Lejes Mjedisore, të 26 qershorit 2020.

151. Në vijim dhe në kontekst të kësaj, paragrafët 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së, përcaktojnë që:

[...]
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në

vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
[...]

6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.

152. Lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se: *"paditësit – propozuesit përmes padisë dhe provave të bashkëngjitura me padi, kanë ofruar prova bindëse me të cilat vërtetohen faktet se ekzekutimi i vendimeve do të sillte dëm qytetareve të cilët jetojnë në pronat tyre dhe jetojnë në atë mjedis ku është parapare puna e këtyre hidrocentraleve, me çfarë do të shkaktohej dëm i pa kompensueshëm atyre".*

153. Bazuar në arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se kjo e fundit nuk ka shqyrtuar dhe dhënë arsyetim për plotësimin e secilit kriter të përcaktuar me nenin 22 të LKA-së, në mënyrë që kjo e fundit të jetë në gjendje që të konstatojë se të gjitha kriteret e përcaktuara me këtë dispozitë janë plotësuar në mënyrë kumulative.

154. Prandaj, Gjykata konsideron se mungesa e arsyetimit të vendimit, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhet edhe me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, përkatësisht kritereve të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së ka rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës.

155. Përfundimisht, bazuar në elaborimin si më sipër dhe duke aplikuar parimet e praktikës së Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, Gjykata konsideron se interpretimi dhe zbatimi i nenit 22 të LKA-së është *"qartazi i gabuar"*, dhe për pasojë ka rezultuar në *"konkluzione arbitrare"* apo *"qartazi të paarsyeshme"* për parashtruesin e kërkesës.

156. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi ARJ-UZVP.nr. 51/2022, i 19 korrikut 2022, i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin AA. nr. 386/2022 të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin A.nr. 3129/2021 të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në kuptim të interpretimit dhe aplikimit të ligjit nuk është në pajtueshmëri me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

II. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

157. Gjykata si më lart konstatoi se Aktgjykimi ARJ-UZVP.nr. 51/2022, i 19 korrikut 2022, i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore janë në papajtueshmëri me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe rrjedhimisht nuk e vlerëson të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet e tij për shkelje të të drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

158. Përfundimisht, Gjykata vë në dukje se ky Aktgjykimi ndërlidhet vetëm përkitazi me procedurën për pezullimin e vendimeve të kontestuara për lëshimin e lejes ujore dhe

asaj mjedisore nga Ministria përkatëse për Mjedis para gjykatave të rregullta, deri sa këto të fundit të vendosin lidhur me meritat e padisë. Çështja e ligjshmërisë së vendimeve të kontestuara të Ministrisë përkatëse për Mjedis është në shqyrtim para gjykatave të rregullta dhe Aktgjykimi i Gjykatës në këtë rast në asnjë mënyrë nuk paragjykon vendimmarrjen e tyre përkitazi me padinë ndaj vendimeve të kontestuara të kësaj ministrie.

Kërkesa për masë të përkohshme

159. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme me arsyetimin se: *"Zbatimi i [këtij Aktgjykimi] do të shkaktoj dëm të paripareueshëm material dhe jo -material për [parashtruesin e kërkesës, pasi që ai do të privohet nga e drejta në ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme bazuar në Lejen Ujore dhe Lejen Mjedisore të dhënë nga organet administrative [...]".*

160. Gjykata veçse ka vendosur për meritat e kërkesës dhe ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht konstaton se vendosja e masës së përkohshme është e panevojshme.

161. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4, 113.1 dhe 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 57 (5) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 dhjetor 2022, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] të 19 korrikut 2022, të Gjykatës Supreme; Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] të 26 majit 2022 të Gjykatës së Apelit; dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;

IV. TË KTHEJË për rishqyrtim Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] të 12 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës;

V. TË URDHEROJË Gjykatën Themelore që ta njoftoje Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores se punës, deri me 10 prill 2023, për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi të Gjykatës;

VI. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;

VII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues | **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban | Gresa Caka-Nimani